

VENDIM
Nr. 720, datë 12.10.2016

**PËR RISHPËRNDARJEN E FONDIT TË INVESTIMEVE PËR FUNKSIONIN E UJITJES
DHE KULLIMIT SIPAS BASHKIVE DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 90,
DATË 4.2.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DETAJIMIN E FONDIT TË
INVESTIMEVE PËR FUNKSIONIN E UJITJES E TË KULLIMIT SIPAS BASHKIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi për investime për funksionet e ujitjes e të kullimit, në shumën 420 867 759 (katërqind e njëzet milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë nëntë) lekë, diferencë nga prokurimi për blerjen e 61 ekskavatorëve dhe rehabilitimin e skemave ujitëse, sipas tabelave 1 dhe 2, të vendimit nr. 90, datë 4.2.2016, të Këshillit të Ministrave, rishpërndahet ndërmjet bashkive për projektet e rehabilitimit të skemave ujitëse, sipas tabelës 2.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 90, datë 4.2.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet sipas tabelës 1.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministri i Financave, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela 1.1 Fondi dhe numri i ekskavatorëve sipas bashkive

Qarku	Bashkia	Vlera në lekë	Nr. i ekskavatorëve gjithsej	Tipi mesatar	Tipi i vogël
Qarku Gjirokastrë	Memaliaj	0	0	0	
Qarku Durrës	Krujë	22,194,000	1	1	
Qarku Fier	Patos	11,508,000	1		1

Tabela: 2.1 Rishpërndarja e Fondit për Rehabilitimin e skemave ujitëse sipas bashkive

Qarku	Bashkia	Vlera në lekë	Emërtimi i skemës ujitëse/objektit
Qarku Berat	Skrapar	37 601 544	Rehabilitimi i kanalit ujitës Vendrezhe (dega e majtë dhe e djathtë)
Qarku Elbasan	Përrenjas	16 847 879	Rehabilitimi kanali vaditës Bratle-Stravaj-Fshat
Qarku Durrës	Shijak	15 997 913	Rehabilitimi i sistemit ujitës Nj.Ad. Gjepalaj, Bashkia Shijak
Qarku Shkodër	Vau i Dejës		
		3 622 614	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U.25
		3 435 522	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U.13
		6 047 826	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U.16
		1 828 278	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U.20/1
		935 888	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U Bushat-Rranza
Qarku Korçë	Pogradec		
		24 328 020	Rehabilitimi i rrjetit ujitës në rezervuarin e Luadhit të Çelos, Pogradec
		9 089 121	Rehabilitim kanali ujitës Ura Leshnice-Cerrave
		3 910 164	Rehabilitimi i kanalit ujitës Kraste e Paxhves - shkolla Blace
Qarku Kukës	Kukës	30 000 000	Rehabilitimi i Kanalit të Uzinës, Kukës (rehabilitim i pjesshëm)
Qarku Vlorë	Konispol	33 005 148	Rehabilitimi i infrastrukturës vaditëse të fushës së Rrahut
Qarku Fier	Mallakastër	19 000 000	Rehabilitimi i rrjetit ujitës të rezervuarit Çorrush nr. 1, Kute, Mallakastër (rehabilitim i pjesshëm)
Qarku Lezhë	Mirditë	37 019 017	Rehabilitimi i rrjetit ujitës të Ujëmbledhësit Malaj-2 (vazhdim)
Qarku Korçë	Korçë		
		29 500 000	Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujitëse, Bashkia Korçë
		15 000 000	Rikonstruksion i veprave ujitëse në zonën jugperëndimore të Fushës së Korçës
Qarku Gjirokastrë	Përmet	26 877 290	Kanali ujitës i Çarshovës
Qarku Tiranë	Tiranë		
		17 400 000	Rehabilitimi i kanalit ujitës Vilez, Zall Bastar
		25 000 000	Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujitëse TRU-20,

			Kanali Arbane (rehabilitim i pjesshëm)
Qarku Elbasan	Librazhd		
		9 986 000	Rikonstruksioni i kanalit vaditës Funares (nga Sifoni-lagjja Prosi) Nj.A. Orenje
		5 929 000	Rikonstruksioni i kanalit vaditës Gurra e Zezë - Frashër, Mnjolle Nj.A. Hotolisht
		8 153 000	Rikonstruksioni i kanalit vaditës të fshatit Zgosht Nj.A. Lunik
		12 000 000	Rikonstruksioni i kanalit vaditës të lagjeve Gostime+Doci+Alimetaj
		4 000 000	Rikonstruksioni i kanalit vaditës të lagjeve Gjell+Braho Nj.A.Polis
Qarku Fier	Lushnjë	9 629 247	Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujitëse të Pajallise
Qarku Gjirokastrë	Tepelenë	2 910 562	Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj
Qarku Gjirokastrë	Dropull	3 700 000	Kanali ushqyes Rezervuari Pepel (+200m ³ beton)
Qarku Lezhë	Kurbin	6 929 416	Linja e vaditjes ndërmjet dy sifoneve në fshatin Zheje, Kurbin